

Korniza ligjore për të krijuar një mjedis të sigurt edukimi.

The legal framework to create a safe educational environment

Në shumë vende, kërkohet që nxënësit të ndjekin shkollën sipas rregullave të detyrueshme të frekuentimit. Një mjedis i sigurt shkollor garanton një mjedis të sigurt të nxëni.

In many countries, students are required to be at school under compulsory attendance rules. A stable school setting enhances a safe learning environment.

Dhuna dhe siguria e shkollës ngrenë pyetje ligjore për të drejtat kushtetuese, procesin e drejtë, detyrimin, fshehtësinë dhe të dhënat, disiplinën.

Violence and associated school safety raise legal questions about constitutional rights, due process, liability, privacy and records, discipline.

Shkollat zhvillojnë politika të qarta proaktive dhe konsistente për të mbështetur një mjedis të sigurt edukativ dhe për të publikuar, zbatuar dhe vijuar këto politika të sigurisë.

Schools develop proactively clear and consistent policies to promote a safe educational environment and have to publish, implement and maintain these safety policies.

Shkollat kanë detyrë të ofrojnë një mbikëqyrje të arsyeshme të nxënësve dhe të garantojnë sigurinë e mjedisit të shkollës. Nëse këto masa janë të përshtatshme, rreziku i dhunës dhe i ndikimit të saj në shkollë do të pakësohet.

Schools have a duty to provide reasonable supervision of students and maintain the safety of the school grounds. If these measures are appropriate, the risks of violence as well as its effects at school aftermath will be reduced.

Administratorët e shkollës, mësuesit, ose bordi i shkollës përballen me detyrime potenciale ligjore për dëmet civile shkaktuar nxënësve në aktet e dhunës të nxënësve ose personave të tjerë.

School officials, teachers, or the school board face potential liability for civil damages for students harmed in the violent acts of students or non-students.

Kjo ndodh veçanërisht, kur ata dështojnë të mbikëqyrin një zonë të veçantë të shkollës ku raste të mëparshme të dhunës kanë ndodhur, kur ata dështojnë për të paralajmëruar nxënësit në lidhje me një rrezik para-ekzistues, ose dështojnë t'i përmbahen planit të tyre të sigurisë së shkollës.

This is especially, when they fail to supervise a specific area at school where prior instances of violence occurred, when they fail to warn students about a pre-existing danger, or fail to adhere to their school safety plan.

Shkollat duhet të garantojnë se nxënësit e filllores, të arsimit bazë dhe të shkollës së mesme si dhe prindërit janë të informuar në një mënyrë të kuptueshme për dispozitat e kodit të shkollës për sjelljen dhe planin e sigurisë.

Schools must ensure that primary-, secondary-, or higher school-age students and parents are informed in an understandable way about the provisions of the school conduct code school and of the safety plan.

Si pjesë e procedurave që lidhen me regjistrimin e nxënësve, shkollat duhet t'u kërkojnë nxënësve dhe prindërve të nënshkruajnë formularët se ata e kanë lexuar kodin e shkollës për sjelljen.

As a part of procedures related to student enrollment, schools might ask students and parents to sign forms stating they have read the school conduct code.

1. Arsyeshmëria

Për të qenë të vlefshme, qëllimi i veprimeve të shkollës dhe metodat e përdorura duhet të jenë ligjore dhe të arsyeshme. Ky është standardi që siguria e shkollës dhe politikat dhe planet e parandalimit të dhunës duhet të plotësojnë.

1. Reasonableness

In order to be valid, the aim of school's actions and the methods used should be legitimate and reasonable. That is the standard that school safety and violence prevention policies and plans should meet.

Shkollave u kërkohet të dëshmojnë të njëjtën shkallë përkujdesjeje dhe mbikëqyrjeje që një prind i kujdesshëm dhe i arsyeshëm do të tregonte në ato rrethana

Schools are required to show the same degree of care and supervision that a reasonably prudent parent would employ under the circumstances.

Administratorët e shkollës balancojnë pranimin e nxënësit në arsim, autonominë dhe fshehtësinë me nevojën për një mjedis shkolle të sigurt dhe ruajtjen e rendit dhe të kontrollit.

School officials balance student's access to education, autonomy and privacy with the need to make the school environment safe and maintain order and control.

2. Çështje të fshehtësisë

Shkollat janë përfshirë në ruajtjen e të dhënave (të dhënat shkollore, mjeksore, disiplinore të nxënësve, raportet e krimet, të dhënat mësimore) dhe duhet të marrin hapa të përgjegjshëm për të ruajtur konfidencialitetin.

2. Privacy issues

Schools are involved in significant record-keeping (including student's school records, medical, disciplinary records, crime reports, educational records) and should take reasonable steps to ensure that confidentiality is maintained.

Çështjet e fshehtësisë duhet të mbahen parasysh gjatë këshillimeve brenda shkollës, midis shkollave, me organizatat sociale dhe shëndetësore si dhe agjencitë e zbatimit të ligjit.

Privacy issues should be taken into consideration in counseling matters within schools and between schools, social and health organizations, and law enforcement agencies.

Shkollat mund t'u japin informacion mësuesve që kanë një interesim të ligjshëm për sjelljen e nxënësve.

Schools may disclose information to teachers who have a legitimate interest in the behavior of the student.

Raportimi i informacionit të nxënësit një shkolle ose një agjencie tjetër është një çështje delikate.

Në përgjithësi, një shkolle që i bën të ditur të dhëna mësimore një shkolle tjetër duhet të bëjë një përpjekje të arsyeshme për të njoftuar prindin ose nxënësin.

Reporting student information to another school or agency is a delicate matter.

Generally, a school that discloses an education record to another school must make a reasonable attempt to notify the parent or the student.

Përgjithësisht, ligji ia kufizon të drejtën për t'u informuar për të dhënat e nxënësit individëve ose organizatave jashtë shkollës pa një miratim me shkrim nga prindërit, me përjashtim të përdorimit të drogës, armëve nga nxënësit në mjediset e shkollës, dhe të sjelljes që ka arritur nivelin e shkatërrimit të pronës ose të rasteve të agresionit të nxënësve ose të personelit të shkollës.

Generally the law restricts access to student records by non-school individuals or organizations without written consent from the parents, with exceptions for possession of drugs or weapons by students on school grounds, and behavior that reach the level of destruction of property or assault of fellow students or school personnel.

Dhënia e informacionit për mosrespektimin e mësuesve ose të stafit, për ngacmimet, për historinë e sjelljes ose akademike, interesat personale, veprimtaritë ekstrakurrikulare, ose informacion të ngjashëm për një nxënës do të kërkojë njoftimin dhe pëlqimin e prindit të nxënësit para se informacioni t'i jepet një pale të tretë.

The release of information on disrespect for teachers or staff, bullying, behavioral or academic history, personal interests, extracurricular activity, or similar background information on a student will require notification to and consent of the student's parents before the information can be released to a third party.

Shkollat zbatojnë një tërësi standardesh për masat e sigurisë nën kujdesin e tyre nëse metodat e përdorura janë të arsyeshme.

Schools employ a standard set of security measures at their discretion if the methods actually used are reasonable.

Masat e shkollës për sigurinë mund të përfshijnë:

- detektorë për metalet,
- kamera,
- politika të uniformës,
- investigim dhe konfiskim.

School safety efforts may include:

- metal detectors,
- cameras,
- dress code policies,
- search and seizure.

Rreziqet e dëmtimit nga një person tjetër mund të përfshijnë forma të ndryshme si:

- rreziqe të drejtpërdrejta
- rreziqe të tërthorta
- rreziqe të fsheura
- rreziqe të kushtëzuara

Threats of harm to another person may take several forms including:

- direct threats
- indirect threats
- veiled threats
- conditional threats

Të drejtat e fjalës së nxënësit mund të kufizohen kur ato shkelin të drejtat e të tjerëve ose kur ato dëmtojnë punën e klasës ose shkaktojnë një çrregullim të konsiderueshëm.

Students' speech rights may be limited where they infringe on the rights of others, or if they disrupt class work or cause substantial disorder.

Një investigim duhet të justifikohet në fillim të tij, të drejtohet në një mënyrë të arsyeshme në kontekstin e rrethanave, aq sa është e domosdoshme për rendin në shkollë, pa atakuar të drejtat e nxënësit.

A search must be justified at its inception, conducted in a manner reasonably related in scope to the circumstances, no more invade student's rights than necessary to maintain order in schools.

Stafi i shkollës mund të kontrollojë një nxënës dhe të procedojë me një pezullim të arsyeshëm. Mësuesit dhe stafi duhet të tregojnë kujdes të dokumentojnë vëzhgimet e tyre paraprake, burimet e informacionit, të investigojnë evidencën dhe të verifikojnë besueshmërinë e informacionit të dhënë nga të tjerët që çon në baza të arsyeshme për një kërkim.

School staff may frisk a student and proceed on reasonable suspicion. Teachers and staff should be careful to document their preliminary observations, sources of information, investigate evidence and verify the reliability of the information given by others that leads to reasonable grounds for a search.

Shkolla ka dollapë dhe investigimi i dollapit është i lejuar si funksion i administratës së një shkolle, por investigimi nuk duhet të shtrihet në sendet personale të nxënësit brenda dollapit veç kur nxënësi jep lejë për të investiguar gjërat në dollap dhe kur leja është dhënë pa shtrëngim dhe ndikim të paligjshëm.

The school owns the locker and locker searches are permissible as a function of the orderly administration of a school but the locker search should not extend to a student's private articles within the locker unless the student gives permission to search the items found in the locker and that permission is not obtained through coercion or undue influence.

Investigimi i trupit është një sulm ndaj intimitetit.

Shkollat duhet t'u shpjegojnë nxënësve këtë lloj investigimi në përputhje me një politikë paraprake.

Strip search represents a serious invasion of privacy.

Schools must thoroughly explain the search to the student in accordance with a pre-existing policy.

Ajo mund të jetë e arsyeshme kur sendi nuk gjendet në vende të tjera dhe ka arsye të besohet se nxënësi e zotëron atë dhe politika për investigimin e trupit ekziston dhe ajo duhet zbatuar.

It may be reasonable when the item cannot be found in other locations, there is reason to believe the student possessed the item, and a policy outlining the strip-search procedure exists and is followed.

Investigimi nëpërmjet detektorit të metaleve është një masë sigurie e lejuar kur ekziston një politikë e shkollës për këtë gjë dhe kur një paralajmërim (për shembull një shenjë e dërguar) është dhënë dukë nënvizuar se investime të tilla do të bëhen në atë shkollë.

Metal detector searches are permissible security measures when a school policy governing such searches is in place and when notice (e.g., a posted sign) has been given stating that such searches will be conducted at that school.

Procedura të pararegulluara duhet të rregullojnë përdorimin e metodave të tjera të zbulimit të metaleve për të kontrolluar nxënësit për objekte metalike dhe duhet të kërkojnë një dyshim të arsyeshëm për t'u përdorur.

Pre-established procedures should regulate the use of other metal-detecting methods to inspect students for metallic objects, and require a reasonable suspicion in order to be used.

Fotografimi i zonave publike si autobuzëve, korridoreve, klasave, mensave është i lejuar.

Photographing public areas such as buses, hallways, classrooms, and cafeterias is permissible.

Kur një nxënës ka një pritshmëri të fshehtësisë në zonën ku filmohet, përdorimi i kamerës është normalisht i papranueshëm.

Kamerat e vendosura në dhomat e zhveshjes së djemve dhe të vajzave mund të mos jetë e arsyeshme kur nxënësit me të drejtë presin një shkallë intimiteti dhe problemi mund të trajtohet ndryshe.

Where a student has an expectation of privacy in the area being filmed, the use of a camera is normally unacceptable.

Cameras placed in boys and girls locker rooms may not be reasonable when students' rightly expect some degree of privacy and the problem might be addressed otherwise.

Rregullat mund të mbartin një lidhje të arsyeshme me mision edukativ të shkollës të përcjellë në një mjedis edukativ të sigurt.

Rules must bear some reasonable relationship to the educational mission of the school conducted in a safe educational environment.

Veprimtaritë investiguese të policisë në shkollë duhet të jenë objektivisht të arsyeshme në tërësinë e rrethanave, bazuar në një vlerësim të pavarur të fakteve specifike dhe të identikuara në situatën e dhënë.

The investigatory or search activities of police in a school must be objectively reasonable under the totality of the circumstances, based on an independent assessment of specific and identifiable facts in that situation.

Shkollat kanë përgjegjësinë të garantojnë sigurinë e mësuesve dhe nxënësve dhe të kenë një detyrim të ndërmarrin veprime që kanë të bëjnë me të rinj të padisiplinuar, të cilët potencialisht mund të kërcënojnë sigurinë e fëmijëve të tjerë të pranishëm.

Schools have the responsibility to ensure the safety of teachers and students and have an obligation to take action in dealing with undisciplined youths, who may potentially threaten the safety of the other children in attendance.

Shkollat kanë fleksibilitet të madh të përcaktojnë dhe të vendosin metoda disipline dhe t'i përgjigjen me disiplinë rreziqeve të dhunës të demonstruar nga nxënësit, dhe të pezullojnë ose përjashtojnë nxënësit për shkelje të rregullave të shkollës me kusht që ata të respektojnë të drejtat bazë si procesi i drejtë ligjor, mbrojtja e barabartë, fjala e lirë, liria nga diskriminimi në bazë të racës, fesë, gjinisë, paaftësisë ose origjinës kombëtare. Schools have great flexibility to determine and establish disciplinary methods and may respond with discipline to threats of violence made by students, and suspend or expel students for infractions of school rules provided they respect fundamental rights such as due process, equal protection, free speech, freedom from discrimination based on race, religion, gender, disability, or national origin.

Metodat e disiplinës të përdorura nga shkollat përfshijnë ndalimin, izolimin, programe alternative edukimi, ndalim të pjesëmarrjes në veprimtari të shkollës, qortim verbal, pezullim, dhe përjashtim.

Disciplinary methods employed by schools include detention, time-out or isolation, alternative education programs, denial of participation in school activities, verbal reprimand, suspension, and expulsion.

Një nxënës mund të ndëshkohet për sjelljen brenda ose jashtë shkollës nëse shkolla mund të dëshmojë se veprimet e nxënësit kanë një lidhje të drejtpërdrejtë dhe efekt të menjëhershëm në disiplinën e shkollës dhe ose në sigurinë e nxënësve dhe të stafit.

A student may be disciplined for on-campus and for off-campus conduct if the school can show that the student's actions have a direct and immediate effect on school discipline and/or the safety of students and staff.

Arsyet për pezullimin ose përjashtimin e nxënësve janë:

- nxënësit kapen me armë dhe objekte të tjera të rrezikshme në mjediset e shkollës,
- rreziqet e dhunës nga ana e nxënësve, duke përfshirë edhe sulmet që nuk përfshijnë përdorimin e një arme.

Reasons for suspension of expulsion of students are:

- students found with a weapon and any other inherently dangerous objects on school grounds,
- threats of violence from students, including assaults not involving the use of a weapon.

Kërkesa të caktuara procedurale duhet të ndiqen nëse një nxënës duhet të pezullohet për një periudhë të caktuar kohore ose të përjashtohet nga shkolla. Përgjithësisht, përjashtimi jepet vetëm në rastet e përsëritjes ose të sjelljes ekstreme, kur sulmon një nxënës ose mësues, në rastin e përdorimit të drogës, të kërcënimit me armë ose të përdorimit të tyre.

Certain procedural requirements must be followed if a student is to be suspended for a substantial period of time or expelled from a school. Generally, expulsion is warranted only in cases of repeated or extreme misconduct, attacking a fellow student or teacher, drug use, and weapons possession or use.

Mbrojtja procedurale përfshin:

- Njoftimin e nxënësit dhe të prindit;
- Një seancë të drejtë dhe të paanshme dëgjimi;
- Të drejtën për t'u përfaqësuar nga një mbrojtës;
- Një kohë të arsyeshme për t'u përgatitur;
- Mundësinë për të shqyrtuar provat;
- Mundësinë për të shqyrtuar ose paraqitur dëshmitë;
- Regjistrim të materialeve;
- Vendimin e bazuar në një evidencë të pasur.

Procedural protection includes:

- Notice to the student and parents;
- A fair and impartial hearing;
- Right to be represented by counsel;
- Reasonable time to prepare;
- The opportunity to review evidence;
- The opportunity to examine or present witnesses;
- Record proceedings;
- Decision based on substantial evidence.

Përgjithësisht, njoftimi dhe një seancë dëgjimore duhet të paraprijë largimin e nxënësit nga shkolla, përveç kur nxënësi paraqet një kërcënim të pashmangshëm për atë vetë apo sigurinë e të tjerëve, dhe në rastin e sjelljes që seriozisht prish atmosferën akademike të shkollës, rrezikon nxënësit e tjerë, mësuesit ose stafin, ose dëmton pronën.

Generally, notice and a hearing must precede a student's removal from school, except when the student presents an imminent threat to him or herself or the safety of others, and in the case of conduct that seriously disrupts the academic atmosphere of the school, endangers other students, teachers or staff, or damages property.

Në situata emergjente, një qasje me dy hapa mund të përdoret:

së pari, kërkoni menjëherë një pezullim ose përjashtim të përkohshëm;

së dyti, zbatoni një përjashtim përfundimtar pas një njoftimi dhe dëgjimi të kryer sa më parë të jetë e mundur.

In emergency situations, a two-step approach may be employed:

- first, immediately impose a temporary suspension or expulsion;
- second, enforce a permanent expulsion after the proper notice and hearing provided as soon as practicable.

PËRFUNIM

Politikat e shkollës duhet të synojnë në ndërgjegjësimin e fëmijës të respektojë ligjin, dinjitetin dhe integritetin e të gjithë anëtarëve të komunitetit të shkollës.

Drejtësia e vërtetë nuk ka të bëjë aq me përpjekjet për dënimin dhe ndëshkimin e saktë sesa me punën për të rindërtuar një mjedis edukimi të sigurt dhe të qetë.

CONCLUSION

School policies should be aimed at awakening the child respect for the law and for the dignity and integrity of all the members of the school community. True justice is less about the effort to exact punishment and retribution but about working to repair a safe and peaceful educational environment.